



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 312/3 Prot.

Tiranë më 28.2.2019

REKOMANDIM

Nr. 17, datë 28.2.2019

PËR KONTROLLUESIN “KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Komiteti Shtetëror për Kultet”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 63 datë 22.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Komiteti Shtetëror për Kultet”, me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: “...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur një rubrikë “*Politikat e privatësisë*” në portalin <http://www.kshk.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “*Politikat e Privatësisë*”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*” dhe Vendimit nr. 6/2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit kontrollit, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por u shprehën se nga institucioni do ndërmerren masa për rikuperimin e tyre.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi “*Komiteti Shtetëror për Kulturën*” në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit “*Njoftimin*” në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
2. Kontrolluesi “*Komiteti Shtetëror për Kulturën*”, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet “*Politikës së Privatësisë*” në portalin zyrtar <http://www.kshk.gov.al>.
3. Kontrolluesi “*Komiteti Shtetëror për Kulturën*”, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave*”

*Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28.2.2019.

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

